

PROBLEME DHE DISKUTIME

XHEVAT LLOSHI

MBI RREGULLËSITË NË NDRYSHIMET E EMRAVE TË NJERËZVE

Gjallërimi i studimeve shqiptare në lëmin e onomastikës është një nga shfaqjet e atij zhvillimi të gjithanshëm, që ka marrë gjuhësia jonë në përgjithësi në këta vjet pas çlirimit. Është e kuptueshme, që hapat përpara në këtë drejtim kërkojnë, nga njëra anë, vlerësimin e rezultateve të arritura deri sot¹, nga ana tjetër, mbledhjen e gjithanshme të materialit konkret, detyrë të cilën do ta zgjidhë me sukses kartoteka përkatëse. Mbi këtë bazë mund të ecin më tej edhe punimet e veçanta për një varg çështjesh².

Përveç kësaj, ne mendojmë se ky gjallërim bën të nevojshëm edhe diskutimin e disa çështjeve të përgjithshme, nga zgjidhja e të cilave do të përcaktohet edhe drejtimi i trajtimit të anëve të veçanta e konkrete. Pa një rrahje dhe kthjellim të tillë teorik, krahas punës konkrete, krijohet mundësia, që zgjidhja e disa çështjeve të mos hyjë në rrugën e duhur. Duke u kufizuar me emrat e njerëzve, do të prekim disa veçori të tyre të njohura përgjithësisht, por që e vlen të përsëriten në diskutimin për lëndën konkrete të shqipes.

Emrat e përveçëm të njerëzve formojnë një klasë të veçantë fjalësh³. Arësyeja themelore e kësaj është semantika. Megjithëse një pjesë e emrave të njerëzve (si *Manushaqe*, *Bukurie*, *Dashamir*, *Petrit* etj.) kur lindin kanë një kuptim, në përdorimin e vërtetë si emra njerëzish nuk kanë vlerë të mirëfilltë semantike (kështu, p.sh. një vajzë e quajtur *Bukurie* mund të mos jetë fare e bukur). Emri kthehet në një tregues, në një shenjë neutrale, që vetëm e tregon dhe e dallon njeriun përkatës, por nuk jep një përmbajtje të caktuar, si fjalët e tjera. Për këtë arësye emrat e njerëzve i kanë afruar me përëmrat⁴.

Përmbajtja semantike e mirëfilltë nuk është një anë e domosdoshme

1) Një pasqyrë përmbledhëse për studimet onomastike shqiptare, bashkë me vlerësimin e tyre, e gjejmë te Androkli Kostallari, *Contribution a l'histoire des recherches onomastiques dans le domaine de l'albanais*, në «Studia Albanica», 1965, nr. 1.

2) Shih Palok Daka, *Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1968, nr. 3, f. 138.

3) Për arësytimin teorik mbi nevojën e veçimit të kësaj klase fjalësh shih J. Kurylovic, *Polozhenie imeni sobstvennovo v jazyke*, në përmbledhjen «Oçerki po lingvistike», M. 1962.

4) Shih J.A. Huismann, *Unerforschte Gebiete der Namenkunde*, «VI. Internationaler Kongress für Namenforschung», Band II, München, 1961, f. 362.

për ta, si për fjalët e tjera, prandaj nuk lidhen me një nocion të caktuar⁵. Këtu është me vend të përmendim fjalët e njohura të Marksit për emërtimet: «Unë nuk di asgjë për një njeri, po të di vetëm se atë e quajnë Jakob»⁶. Në leksikun e gjuhës ata veçohen nga fjalët e tjera dhe as nuk përfshihen dot në një fjalor shpjegues të zakonshëm⁷ (me përjashtim të togjeve frazeologjike).

Me terma të tjera mund të thuhej se, emrat e përgjithshëm na transmetojnë një informacion për diçka, fiksojnë njohuritë e arritura në nocionin përkatës, ndërsa emri i përveçëm i njeriut nuk përmban informacion, nuk ka për qëllim të kryejë këtë funksion.

Me këtë gjen shpjegim fakti i përhapjes së emrave nga një gjuhë në tjetrën e i shtegtimin pa kufizime gjuhësore. Edhe kur si emër i përveçëm është përdorur një emër i përgjithshëm, ai nuk është marrë në kuptimin e parë, të drejtpërdrejtë, p.sh, emrat *Guri, Agim, Pëllumb, Lule* etj. lindin mbi nuancat emocionale-shprehëse dhe kuptimet e figurshme. Kështu emrat e përveçëm nuk mund të kenë një kuptim të parë dhe një zhvillim të rregullt semantik si fjalët e tjera⁸. Në këtë klasë fjalësh është e hapur rruga për ndikimin e gjithmbarshëm të faktorëve jashtëgjuhësorë, si zakonet, traditat familjare, feja, moda, letërsia, trillet individuale, parapëlqimi subjektiv i disa togjeve fonetike etj⁹.

Përfundimi, që paraqet interes për çështjen në diskutim, është ky: ndryshimet e pësuar nga emrat e përveçëm do të jenë të tjera nga ndryshimet e fjalëve të zakonshme. Një fjalë e përgjithshme nuk mund të pësojë një ndryshim që do të thyente njësinë e formës me përmbajtjen dhe që do të sillte ngatërime në kapjen e drejtë të informacionit që sjell fjala. Kurse p.sh. kalimi nga *Viktori* te *Vito*, nga *Qeramudin* te *Qamo*, nga *Agron* te *Goni* nuk lind një rrezik të tillë. Prandaj fjala *manushaqe* ndryshon në gjuhë sipas disa rregullësive, që ruajnë këtë njësi, ndërsa emri *Manushaqe* mund të ndryshojë në *Shaqe* jashtë këtyre rregullësive.

Disa veçori të tjera të emrave të përveçëm lidhen me përdorimin e tyre. Nevoja për t'i përdorur shpesh, sidomos për të thirrur tjetrin, jashtë lidhjeve sintaktike, ndikon në shkurtësinë e tyre, ata bëhen një kategori

5) «Emrat e përveçëm nuk lidhen me nocionet dhe për këtë formojnë në gjuhë një klasë të veçantë fjalësh». J. Stepanov, *Francuzskaja stilistika*, M. 1965, f. 172.

6) K. Marks, *Kapitali*, vëll. I, 1, përkth. shqip. T. 1963, f. 142.

7) «Pozita e kësaj kategorie fjalësh në sistemin e leksikut... është e veçantë. Të tërheq vëmendjen para së gjithash fakti, që emrat e përveçëm të njerëzve nuk përfshihen në fjalorë. Pse? Me sa duket, sepse emrat e përveçëm nuk kanë nevojë për shpjegim; rrjedhimisht, ata nuk kanë «kuptim» në kuptimin e mirëfilltë të kësaj fjale. Mjafton të tregohet që kjo ose ajo fjalë është emër njeriu dhe kërkesa për shpjegimin e kësaj fjale bie», V.K. Çiçagov, *Iz istorii russkikh imjon, otcestv i familij*, M. 1959, f. 8.

8) «Dihet se studimi etimologjik i emrave të përveçëm është më i vështirë se studimi i fjalëve të tjera (të përgjithshme), mbasi kuptimin e emrave të përveçëm ne nuk e njohim që më parë». B.I. Nadel, *reçension për L. Zgusta, Die Personennamen griechisches Städte der nordlichen Schwarzmeerküste*, Praha, 1955, në «Voprosy jazykoznanija», 1958, nr. 2, f. 153.

9) Janë pikërisht këta faktorë, që bëjnë të mundur të ndihmojë antroponimia ndriçimin e anëve të ndryshme të historisë së popullit. Kështu p.sh. në periudhat e mëparshme emri përcaktohej nga feja, megjithatë për vendin tonë ky faktor gjithnjë ka qenë i lëkundshëm. Edhe emra të tillë, si *Kushtetutë, Monarki, Republikë, Traktor* etj. etj. të cilët me të drejtë kritikohen (shih P. Daka, *Përhapja e emrave vetjakë të fondit kombëtar — kërkesë e kohës*, «Zëri i popullit», 23.IV.69, f. 2), nga kjo anë paraqesin interes, sepse tregojnë vlerësimin emocional-shprehës të nocioneve përkatëse, nga njerëzit që i kanë ngjitur këta emra.

fjalësh, ku i ashtuquajhuri «ligji i ekonomisë në gjuhë» vepron në shkallë tjetër. Por dallimi themelor lidhet me sferën e përdorimit, gjë që përcakton karakteristikat stilistike, emocionale-shprehëse dhe vlerësuese të tyre.

Ndërsa për nevojat zyrtare, në dokumenta, në përgjithësi në marrëdhënjet e punës e shoqërore, përdoret një trajtë (I) e plotë (e shoqëruar sipas nevojës me mbiemrin, me fjalën *shok* etj.), në bisedën e përditshme e familjare përdoret një trajtë tjetër (II), p.sh. trajtave I *Andrea, Ramadan, Afërdita, Garentina* u përgjigjen në ligjërimin përditës e kuvendor trajtat II *Ndreçi, Dane, Dita, Gato*. Kemi kështu një dallim shtresash stilistike¹⁰.

Përdorimi i gjerë i dy trajtave të një emri të përveçëm në të njëjtën kohë dhe po për atë njeri, përbën një nga veçoritë më karakteristike, që e dallon atë nga emrat e tjerë të përgjithshëm.

Prandaj në emrat e trajtës II kanë vend të gjerë ndryshimet me prejardhje emocionale-shprehëse dhe vlerësuese, si shkurtime, geminacioni, dyzimet, derivimi me prapashtesa zvogëlimi e përkëdhelie etj.¹¹ Mjafton të kujtojmë, se nganjëherë këto janë trajta të lindura në gojën e fëmijëve, të cilat nguliten (gjë e pamundur përgjithësisht për fjalët e leksikut të përgjithshëm), për të kuptuar se sa elementë subjektivë e të rastit ndikojnë në trajtat II.

Shkurtime e këtyre trajtave gjejnë ngjashmëri në shkurtime e fjalëve të zakonshme, pikërisht në stilin e ligjërimin përditës e kuvendor dhe prandaj vetëm me këto raste mund të krahasohen. Kështu p.sh. në këtë stil kanë lindur trajtat *kusho, byl, llaçkë, shushe, tikë* etj. për *kushëri, bylmes, budallaçkë, e shushatur, antikë* etj. me ngarkesë të caktuar emocionale-shprehëse. Dallimi i këtyre rasteve është dallimi midis gjuhës dhe ligjërimin.

Duke mos u zgjatur më tej me këto veçori, mund të formulojmë një përfundim të përgjithshëm: emrat e njerëzve formojnë një klasë fjalësh më vete dhe prandaj rregullësitë e ndryshimeve të tyre janë të ndryshme nga rregullësitë e fjalëve të përgjithshme, nga rregullësitë që prekin strukturën e gjuhës. Kështu p.sh. fjala *agim* në gjuhënsHQipe nuk pëson aferezë, pasi kjo dukuri nuk vepron më në shqipen si sistem, ndërsa emri *Agim* ka edhe një trajtë II *Gim*. Pranimi i *Gim* si një aferezë e *Agim*¹², vjen në kundërshtim me këtë ndryshim parimor.

Megjithatë, edhe emrat e njerëzve janë pjesë e gjuhës, ata nuk mund të shkëputen krejtësisht dhe të dalin jashtë ndikimit të sistemit të saj. Për pasojë, *emrat e njerëzve, nga njëra anë, kanë veçoritë e tyre të ndryshme, nga ana tjetër, pasqyrojnë edhe ndryshime të përgjithshme për*

10) J. Stepanov, *vep. e cit.*, f. 174 dallon katër shkallë strukturore të emrave, të cilat u korrespondojnë katër stileve të ndryshme të ligjërimin; ndërsa N.A. Petrovskij, *Silovar russkikh ličnyh imjon*, M. 1966, f. 15 dallon pesë forma të emrit, sipas stileve ku përdoren, duke përfshirë edhe trajtën e vjetër kanonike. Për çështjen në diskutim, mendojmë se është e mjaftueshme kundërvënja e dy trajtave, ndonëse p.sh. edhe ne mund të dallonim *Mri* si trajtë të ligjërimin popullor nga *Maria* si trajtë bazë kishëtare etj.

11) Mbi rolin e ndryshimeve me prejardhje shprehëse shih K. Roelands, *Die Namenkunde als Schlüssel zur psychologischen Erforschung des Sprachentwicklung*, «VI Internationaler Kongress für Namenforschung», Band III, München, 1966, f. 643 vij. Megjithatë nuk mund të pajtohemi me autorin për interpretimin thjesht psikologjik të fakteve, po të kemi parasysh se dallimet stilistike janë me vlerë gjithëgjuesore.

12) Përveç P. Dakës, këtë e ka pranuar më parë si aferezë edhe Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe* (dispensë), T. 1964, f. 118.

fjalët e tjera të gjuhës. Në studimin e tyre del e domosdoshme të dallohen këto dy anë dhe të merren parasysh. Mosdallimi i tyre mund të sjellë në përfundime të padrejta, veçanërisht kur është fjala për rrugën historike të emrave.

Para së gjithash, është e domosdoshme të dallohen trajtat II nga trajtat e tjera sepse, siç u tha, këto trajta II i përkasin një sferë të caktuar. Kështu *Mri* nuk përdoret si trajtë II pranë *Maria*, prandaj ajo nuk mund të vihet në një radhë me *Bam*, *Qako*, *Katinë* etj. që janë trajta të dyta për *Bajram*, *Ibrahim*, *Qiriako*, *Katerinë* etj. siç ngjet në artikullin e cituar të P. Dakës¹³.

Për ta sqaruar këtë le të marrim emrin *Vladimir* dhe trajtën II *Ladi*. Për të lindur kjo trajtë *Ladi* kanë vepruar të gjitha rrethanat, që u përmenden më lart dhe për këtë nuk ka qenë nevoja për asnjë periudhë të gjatë apo të shkurtër, ndërsa për të patur trajtën *Mri* nga *Maria* kanë qenë të domosdoshme ndikimet e dukurive të caktuara fonetike, që veprojnë në periudha të caktuara. Pra *Mri* është rezultat i një procesi historik, i një zhvillimi ku mund të gjurmohen rregullësi, ndërsa *Ladi* nuk është rezultat i ndonjë zhvillimi, ku mund të ndiqen rregullësi të tilla.

Që këtej mund të arrijmë në një përfundim të përgjithshëm: trajtat II, që i dëshmojmë të përdorura pranë trajtave I nuk paraqesin një vazhdimësi fonetike.

Ky përfundim mund të shërbejë si një kriter i vlefshëm për ndarjen dhe shqyrtimin e të gjithë emrave, të cilët kanë ndonjë ndryshim nga trajta fillestare e tyre.

Si grupi i parë (A) dalin emrat, të cilët nuk përdoren si trajta II pranë një trajte I, prandaj për ta ka mundësi të bëhet shqyrtimi nga ana e rregullësive fonetike. Si grupi i dytë (B) dalin emrat, të cilët përdoren si trajta II pranë një trajte I, prandaj për ta nuk ka vend një shqyrtim i tillë. Në shembujt e mësipërm, *Mri* nuk ka përse të quhet fare «shkurtim» i *Maria*, ajo është zhvillimi i saj fonetik, i bërë në gojën e popullit, ndërsa *Ladi* është një shkurtim i vërtetë, i bërë në një stil të caktuar, me ngarkesë emocionale-shprehëse, të cilën nuk e ka fare *Mri*¹⁴.

Kjo do të thotë se është pa vlerë të kërkojmë të gjejmë në bazë të rregullësive fonetike të shqipes se si ka ardhur *Gato* nga *Garentina*, *Dallo* nga *Dallëndyshe*, *Vito* nga *Viktori*, *Miço* nga *Dhimitër*, *Toku* nga *Themistokli* etj. Kjo del bindëse sidomos në krahasimin e fjalëve të përgjithshme me emrat, që kanë lindur mbi bazën e tyre. P.sh. fjalët *petrit*, *bajram*, *ramazan*, *pëllumbeshë*, *bashkim*, *vullnet* etj. janë përdorur si emra njerëzish *Petrit*, *Bajram*, *Ramazan*, *Pëllumbeshë*, *Bashkim*, *Vullnet* etj., por është e pamundur të mendohet, që këtu ka disa rregullësi fonetike të shqipes, të cilat do t'i ndryshonin fjalët e përgjithshme, në atë mënyrë, siç kanë ndryshuar emrat e përveçëm: *Titi*, *Bam*, *Zan*, *Besha*, *Bako*, *Neti* etj.

Me zbatimin e kriterit të përmendur, në grupin A do të dalin ata emra, të cilët me të vërtetë mund të shërbejnë si material për studim fonetik, që mund të ndihmojnë për historinë e tingujve dhe të dukurive të shqipes, shkurt që mund t'i nënshtrohen etimologjizimit të mirëfilltë.

13) Palok Daka, *Mbi disa veçori të formimit të emrave vetjakë në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1968, nr. 3, f. 145.

14) Është e vërtetë, që *Mri* mund të përdoret sot në një veprë letrare për karakterizim stilistik, si e gjuhës së folur ose krahinore, por kjo s'ka të bëjë me funksionin real, që ka pasur kur ka lindur si vazhdim fonetik i *Maria*, shkurt *Mri* nuk është trajtë II e një emri, (në kuptimin që i kemi dhënë kësaj trajte II).

Por edhe këtu studimi kërkon një kujdes të madh, sepse siç e thekson A. Meje: «Gjuhëtarët, që interesohen kryesisht për etimologjinë e emrave të përveçëm, shpesh janë aventurierë në gjuhësi dhe shumë të paktë janë ata, që ndjekin me rreptësi gjithë kërkesat e metodës»¹⁵.

Në dritën e këtyre arësytiveve, ne mendojmë se në artikullin e përmendur të P. Dakës është bërë një përpjekje, që çfarëdo trajte e një emri të nxirret nëpërmjet një ose disa fenomeneve fonetike nga një trajtë fillestare, pikërisht duke ngatërruar trajtat II me emrat e vërtetë, që kanë ndryshuar historikisht. Duke shkuar deri në fund në këtë rrugë, janë nxjerrë edhe përfundime, të cilat nuk pajtohen me dukuritë fonetike të shqipës¹⁶, p.sh. mendohet se është gjetur një alternim *st: c* për shqipen, ose thuhet «edhe rrokja e theksuar mund të bjerë»¹⁷.

Në secilin grup të veçuar në artikull, mund të vihen në dyshim si dukuritë fonetike, ashtu edhe përpjthja e shembujve. Të marrim p.sh. grupin e tretë. Ndarja në dy trajta e një emri (p.sh. *Age* dhe *Tinë* nga *Agetinë*) aty quhet aferezë dhe apokopë. Në pikën *b* thuhet se veç aferezës dhe apokopës, përsëritet edhe tingulli fundor i variantit të parë, pra *Aleksandër* = *Aleks* dhe *Sandër*. Mirëpo njeriun, që e quajnë *Aleksandër*, e thërrasin me trajtën II ose *Aleks* (më rrallë) ose *Sandër* dhe jo me të dy njëherësh. Në këtë rast për trajtat *Aleks* dhe *Sandër* nuk shtrohet çështja as e lidhjes së tyre të drejtpërdrejte dhe jo më përsëritja e një tingulli ndërmyjet tyre. Kjo mënyrë arësytimi ka çuar deri atje, sa të bëhet një pohim i tillë i gabuar, sipas të cilit tingujt që bien nga afereza mund të formojnë derivate të reja. Pra sipas autorit tek *Ikbal* rënka pjesa *Ik-* dhe (megjithëse ka rënë, nuk është më) formoka emrin *Ike*.

Po të pranoni një mënyrë të tillë analize, do të duhej ta përmbysnim kuadrin e fonetikës shqipe si në hapësirë, si në kohë.

Ajo që duam të theksojmë më tepër është, se kështu arrijmë në një vështrim antihistorik të fenomeneve. Janë quajtur njësoj p.sh. si ndryshimet *Mari* > *Mëri* > *Mri*, si *Qiriako* — *Qako*, ose janë barazuar si *Gjon* > *Gjo*¹⁸ edhe *Alqiviadh* — *Alqi*. Për të vërtetuar që afereza «në emrat vetjakë të shqipes shfaqet si një nga dukuritë më të hershme, më të rëndomtë dhe më të shpeshta të fonetikës së shqipes», sillen shembuj si *Shqiponja* — *Ponja*, *Mimozë* — *Moza*, *Adriatik* — *Tik*, *Violeta* — *Leta* etj., për të cilët dihet se kanë hyrë në përdorim fare vonë.

15) A. Meillet, *La méthode comparative en linguistique historique*, Oslo, 1925, f. 42.

16) B.I. Nadel, *vep. cit.*, f. 153 shkruan kështu për gabimet e mundshme në këto raste: «Lidhur me këtë, gjatë shfrytëzimit të emrave të përveçëm për qëllime linguistike, nuk mund të merren parasysh korrespondenca tingullore, që bazohen mbi etimologji të veçanta. Materiali antroponimik për mendimin tonë, mund të merret si burim pak a shumë i sigurtë për historinë e gjuhës dhe të popullit vetëm në rast se përfundimet, e nxjerra me ndihmën e tij, përforcohen nga të dhënat e burimeve të tjera (toponimisë, dëshmitë historike, vëzhgimet etnografike e realie të tjera)».

17) P. Daka, *vep. cit.*, f. 145. Në artikull ka edhe thjesht pasaktësi. Thuhet p.sh. se alternimin *s:c* e vërejmë «në mes të emrit *Hasan*, *Hysen*, *Isuf* (shën. 17, f. 147), ndërsa është e qartë, se alternimi nuk vërehet në mes të këtyre emrave (s'ka *Hacan*, *Hycen*, *Icuf*), por në fillim të trajtave *Can*, *Cen*, *Cuf*. Në po atë faqe, thuhet për grupin e katërt, se formohen prej «një ose dy tingujve fundorë të emrit të plotë + një ose dy prapashtesa», ndërsa shembujt nuk përpjthet as me këtë, as me formimin e shkallëzuar, të përcaktuar nga vetë autori më lart. Ndarja në grupe është pa një kriter të vetëm, pasi është përzjerë fonetika me morfologjinë e fjalëformimit.

18) Në përgjithësi janë harruar dukuri të rëndësishme, si zgjatimi kompensator, natyra e zanoreve dhe pozicioni sintaktik.

Në përgjithësi ne mendojmë se pasaktësitë në artikullin e cituar e kanë burimin pikërisht tek përpjekja për të zbatuar kriteret fonetike mbi një material, i cili nuk është i përshtatshëm për një shqyrtim të tillë¹⁹.

Nga një vështrim i vëmendshëm i grupit të emrave, të cilët me të vërtetë kanë pësuar ndryshime fonetike të rregullta (si p.sh. *Gjon, Gjergj*), del se ata u përkasin periudhave mjaft të hershme, ndërsa në shekujt e fundit numri i tyre bie mjaft. Në ditët tona emrat e rinj pësojnë përshtatjen e zakonshme, që ngjet si për çdo fjalë tjetër kur është e huazuar, ose i nënshtrohen sistemit fonetik të dialekteve (shih edhe më poshtë). Edhe emrat me prejardhje turke rrallë paraqesin ndryshime fonetike të tjera, përveç përshtatjes fillestare kur kanë hyrë në shqipe dhe ndikimeve dialektore. Te emrat me prejardhje bizantine ndryshimet gjithësesi nuk janë tepër të shpeshta. Ndërsa përkundrazi, sot lindja e trajtave II është dukuria më e përhapur.

Kështu prania e dy trajtave I dhe II për një emër del edhe si kriter për shtresimin historik: emrat si *Gjon, Gjergj, Gjën, Ndre, Lekë, Mri, Ndue* etj. që nuk dëshmohen të përdorur si trajta II pranë një trajte tjetër I, janë më të vjetër, ndërsa *Met, Oso, Komi, Cen, Tafë, Loni, Nasi, Dhori* etj. që përdoren pranë një trajte I janë relativisht të rinj (rastet e homonimisë nuk e ndryshojnë çështjen).

Të kalojmë në grupin B, d.m.th. te trajtat që nuk kanë lindur me rrugën e rregullësive fonetike të zakonshme.

Detyra e parë në këtë grup është të veçohen rastet, që lidhen thjesht me fjalëformimin, detyrë kjo që kërkon gjithashtu të merren parasysh veçoritë e emrave të njerëzve si klasë e veçantë, pasi «Mbi ta nuk shtrihen as normat e fjalëformimit, karakteristike për emrat e përgjithshëm, — formimi i emrave të përveçëm përbën një sistem të veçantë»²⁰. Mjafton të sjellim shembuj si *Hike, Sose, Mbarime, Shkurte, Emira, Bukurie, Helme, Fundim, Lindjeta* etj. për t'u bindur se sa larg janë këto raste nga strukturat dhe modelet e fjalëformimit të zakonshëm.

Një veçim të tillë të fjalëformimit nga dukuritë fonetike dhe nga fjalëformimi i emrave të përgjithshëm nuk e gjejmë në artikullin e cituar të P. Dakës²¹.

Çështjet e fjalëformimit ndërthuren dhe me çështjen e formësimit të emrave të njerëzve si fjalë, p.sh. disa emra të plotë ose trajta të tyre nuk përdoren në të pashquarën: *Guri, Beshë, Ndreçi* etj.

19) Po të marrim parasysh fonetikën, na duket se nuk është i drejtë edhe mendimi, që nga *Nikolla* ka ardhur *Kola*. Kjo trajtë mund të lidhet me trajtën e shkurtuar italiane të *Niccolo*. Se çfarë është një ndryshim i vërtetë fonetik del në trajtën e toponimit nga emri i kishave *Shën Kollit*. Ballafaqimi i trajtave të emrave të përveçëm të njerëzve me rastet e përdorimit të tyre në toponimi (e në emërtime të tjera) e vë në dukje fare qartë dallimin midis një fenomeni të vërtetë fonetik dhe një ndryshimi për arsye të tjera (khs. p.sh. *Shënkoll, Shëndëlli, Shtodri, Shëmitër* etj. me *Nikë, Ilija, (Ilo), Todi (Dhori), Miço (Dhimur)* etj.). Në diskutimin e trajtave nuk mund të lihen mënjatë gjuhët e ndryshme si burime të trajtave të ndryshme në shqipen.

20) J. Stepanov, *vëp. cit.*, f. 172-173.

21) Për formimet e veçanta mund të bëheshin vërejtje të ndryshme. Kështu *Binak* nuk vjen nga ndonjë *Bin*, por është fjala *binjak* e përdorur si emër njeriu. Po kjo fjalë ndeshet në Verilindje edhe si *dinak*, p.sh. për një personazh të kanunit *Binak Alia*, prandaj dhe patronimi *Gjindinaku*, i përmendur te Mahir Domi, *Burime dhe materiale të shqipes së shekullit XV*, «Studime filologjike», 1963, nr. 3, f. 74, do kuptuar si *Gjin binjaku*. Për emrin *Gjeto* është shprehur mendimi, që lidhet me *Çeto* (në rapsoditë: *Gjeto Basho Muji*). Prapashtesat disa herë janë homonime dhe nuk mund të përzjehen p.sh. te *Paç, Panoç, Vanç, Tuç* etj.

Pasi të kemi veçuar trajtat e prejardhura në grupin B, do të mbetet një numër i madh trajtash të tjera, të cilat nuk gjejmë shpjegim as me rrugën fonetike, as me fjalëformimin. Të tilla janë trajtat II si: *Bam, Bim, Dik, Komi, Loni, Cen, Cuf, Lef, Tasi, Duro, Dhori, Ladi, Dhimo, Beni, Gori, Caci, Lem, Loli, Koci, Kiçi*, etj. etj.

Ne mendojmë se në këto raste kemi të bëjmë me një shfaqje të veçantë për emrat e njerëzve, të cilën do ta quajmë riformim. Thelbi i këtij riformimi është ky: nga emri merren një tingull, një rrokje ose disa tinguj për të ndërtuar trajtën II. Këta tinguj zgjidhen përgjithësisht të tillë, që të ruajnë një farë lidhjeje të të dy emrave (prandaj p.sh. merren më shpesh zanoret e theksuara dhe bashkëtingëlloret karakteristike). Ky riformim në dukje del mjaft arbitrar, porse formimet e reja në të vërtetë u nënshtrohen ligjeve më të përgjithshme fonetike të fjalës shqipe. Prandaj modeli ideal i këtyre ndërtimeve është një fjalë dyrokëshe, me theksin në rrokjen e parafundit, që fillon me një bashkëtingëllore dhe me rrokjen e dytë të hapur (pra bashkëtingëllore + zanore e theksuar + bashkëtingëllore + zanore e patheksuar). P.sh. nga emri *Abdurrahim* del trajta e riformuar *Duro*, nga *Stilian* — *Tili*, nga *Abdullah* — *Dullë*, nga *Ibrahim* — *Bimi* etj.

Ky model është i përbashkët për të gjitha trajtat II të shqipes. Dhe vetëm pasi është bërë ky riformim, trajta II i nënshtrohet tashmë në mënyrë të rregullt sistemit fonetik. Kjo do të thotë, pra, që në dialektet, ku vërehet errësimi i zanores pastheksore dhe rënja e saj e mëtejshme, edhe trajtat II do të dalin njërokëshe, prandaj vërehet një shpërndarje e qartë e trajtave një ose dyrokëshe sipas dialekteve. P.sh. nga *Muharrem* është e qartë që *Rremë* ose *Rrëm* janë krijuar në një rrethim tjetër dialektor nga *Muho*, e po kështu *Sulë* (*Sül*) kundrejt *Sulo* nga *Sulejman* etj. Kjo do të thotë p.sh. se *Cen, Cuf, Can* (*Con*) kanë lindur në dialektin, ku *s* nistore në disa kushte kalon në *c*, gjë që shoqërohet edhe me kalimin *z* në *x*, e prandaj *Ramazani* do të riformohet atje me doemos në *Xan* (*Xon*). Kështu tani mbi këto trajta të riformuara zbatohet parimi i njohur i fonetikës: rregullësia fonetike përfshin gjithë grupin e fjalëve, ku tingulli përkatës gjendet në pozicion të njëjtë.

Natyrisht, edhe këtu mund të veprojë analogjia e modeli, p.sh. kur ka një trajtë II të njohur *Man*, është lehtë që të riformohen kështu të gjithë emrat, të cilët përmbajnë grupin *-man-*, pra *Emanuel, Sulejman, Abdurrahman, Osman, Liman* etj. Trajta e riformuar përfshihet edhe në fjalëformim, p.sh. nga *Ibrahim* trajta II *Braho* mund të marrë prapatshtë e kemi *Braçe*, ose nga *Islam* trajta II *Lame* mund të shtjellohet në *Lamçe* etj.

Shqyrtimi i mëtejshëm i këtij modeli, me variantet e veta dhe me ndërthurjen e fjalëformimit e të formësimit, mund të nxirrte në pah veçori të tjera, mirëpo nuk do të hyjmë në një shqyrtim të tillë, pasi qëllimi i këtij diskutimi është të tregojë, që edhe mbi emrat e ndryshëm të njerëzve veprojnë rregullësitë e shqipes, por *ky veprim zbulohet vetëm po të mbajmë parasysh veçoritë e një materiali të tillë, siç janë emrat vetjakë*.

Përfundimi kryesor që del prej këtej është, se zbatimi mekanik i disa rregullësive për të shpjeguar veçoritë e formimit të emrave vetjakë të shqipes, pa u thelluar në lëndën konkrete dhe pa një sqarim teorik të çështjeve, jo vetëm nuk ndihmon për ndriçimin e këtyre veçorive, por sjell edhe pasaktësi në kuptimin e vetë rregullësive të shqipes.

Nga ana tjetër, tashti mund të ngrihet edhe një hipotezë e përgjithshme. Ndryshimet në emrat e njerëzve, me sa duket, në periudhat e hershme kanë ecur në rrugën fonetike, duke shkuar kjo rrugë drejt rënjes në kohët e reja. Kështu kundërvënja ishte ndërmjet trajtës së plotë (që kryesisht ruhej nën ndikimin fetar) dhe trajtës së ndryshuar në gjuhën e folur e në dialektet, pa ngarkesa të tjera dhe duke e përjashtuar njëra trajtë tjetrën. Ndërsa trajtat e riformuara kanë lindur më vonë, ndoshta në mesjetë, dhe sot janë përhapur gjerësisht, lidhur sidomos me një diferencim më të qartë stilistik.

Rënjen e rrugës fonetike e kanë përcaktuar faktorë të tillë jashtë-gjuhësorë, si ngulitja e sistemeve fetare të emrave, futja e shkrimit, vendosja e administrimit shtetëror, ndikimi i qytetit mbi fshatin dhe në ditët tona sidomos ngritja e përgjithshme kulture dhe formimi i gjuhës letrare të përbashkët. Ndërsa riformimet i përkasin sot gjuhës së gjallë të folur në kundërvënje stilistike me sferat e tjera të përdorimit, duke nënkuptuar medoemos trajta II praninë e emrit të plotë (natyrisht, nuk përjashtohen rastet e neutralizimit të trajtave II e shndërrimi i tyre në emra pa ngarkesë tjetër) dhe duke u përdorur me funksione të caktuara me ngarkesë emocionale-shprehëse e stilistike.